



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:144975

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05731555

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr..../....

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit A..... P.....për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshme PP/II-nr.1495/22 të datës 29.06.2023,pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë në prezencë të Prokurores se Shtetit Ardiana Veseli, të pandehurit A..... P..... dhe mbrojtëses se tij av. F....K..... sipas autorizimit, me datë 16.05.2024 mori dhe shpalli publikisht ndera me datë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

Alfred Pjetraj, i lindur me dt. në P....., ku edhe banon në rr. “B... A... K.....”,pa nr. i biri i P... dhe nënës F... e vajzërisë H....., i martuar, baba i 4 fëmijëve, punoj ne firmën T.... P..., me seli ne P....., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës, qenë në ndalim policor për 48 orë, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

PËR SHKAK SE:

Me datë, rreth orës ...:.... në rrugën H... P..... në P..., pikërisht përballë institucionit financiar A.. – Q..... në P..., personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, me pasojë dëmtimin e përkohshëm të shëndetit dhe atë të dëmtuarit F....Z....., në atë mënyrë që, ditën kritike derisa i dëmtuari F..... ishte duke ecur përgjatë trotuarit në anën e majtë, ku më të arritur në vendin e lartë cekur, i pandehuri A..... nga drejtimi i kundërt vjen me veturën e tipit Sh....., ngjyrë e zezë, del në trotuar i afrohet dhe e godet, ku si pasojë e goditjes i dëmtuari rrezohet duke pësuar ndrydhje në krahun e majtë me çka i shkakton lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndet, siç konstatohen në raportin mjeko ligjor me numër Ref.../...., të datës

-me çka ka kryer veprë penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 42, 43, 44, 69, 70, 71 par.1 nën par. 1.3, neni 185 të KPRK-së, dhe nenin 364 të KPP-së, të pandehurit A..... P.....i shqipton:

DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit komfor nenit 44 të KPRK-së, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 1.000,00 € (njëmijë euro), në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në ndalim policorë (40 €) qenë në ndalim policor për 48 orë, e të cilin dënim prej 960,00 € (nëntëqind gjashtëdhjetë euro) i pandehuri obligohet që ta paguaj brenda 3 (tre) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do të llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 40,00 € në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari F.... (Sh....) Z....., me vendbanim në rr. “B.... e K.....” nr. 48 K. P....., për realizimi e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civile.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 29.06.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1495/22, ndaj të pandehurit A..... P.....për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës gjykata në pajtim me nenin 246 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pas leximit të aktakuzës gjykata është bindur se i pandehuri i ka kuptuar aktakuzat dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar të pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë. I pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, duke shtuar: kërkoj falje, nuk ka me ndodh më, kemi qenë shokë, me vjen keq çka ka ndodh, jam i shkurorëzuar dhe dy fëmijët me ish gruan i kam në përkujdesje dhe atë 7 dhe 8 vite.

Ne vlerësimin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit të Shtetit e cila ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. I njëjti është bërë në mënyrë të plotë dhe komfor dispozitave ligjore. Kërkoj nga gjykata që të këtë parasysh faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe i propozoj gjykatës që pranimi i fajësi të merr si rrethanë lehtësuese me rastin e matejses dhe shqiptimit të dënimit.

Ndërsa mbrojtësja e te pandehurit av. F....K..... lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij ka deklaruar: meqë pas bisedave të bëra me te pandehurin lidhur me veprën penale të cilën jemi duke e shqyrtuar, unë si mbrojtës i te pandehurit ja kam bërë me dije pre-mundësinë që pranimi i fajësisë sjell benifite sa i përket dënimit dhe pas kësaj bisede i pandehuri duke marrë parasysh edhe faktin se janë pajtuar me familjen e F....Z.....t ka vendosur që pa kurrfarë ndikimi apo shtytje të pranohet fajësinë. Për këto shkaqe kërkoj nga gjykata që te pandehurit t'ia shqiptoj një dënim sa më të burtë, duke marrë parasysh se është i vetmi ushqyes i familjes 5 anëtarësh dhe pasaqë ka hyr në punë kështu që qfarë do dënimi tjetër i shqiptar do të kishte pasoja edhe familja e tij. Konsideroj se një dënim i butë e mundësisht e aj dënim, të kthehet me gjobë kishte më qenë dënimi më edukues që në të ardhmen i pandehuri në të ardhmen mos të kryej vepra penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se në seancën e shqyrtimit fillestar nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPRK-se, aktakuza mbështet në këto prova siç janë: raporti fillestar i incidentit 2022 – DA-1231 i datës 18.07.2022; Raporti i policit E... S... #6003 i datës 19.07.2022; Deklarata e të dëmtuarit/dëshmitar F....Z....., e dhënë në Prokurorinë Themelore Pejë Departamenti i Përgjithshëm, me datë 16.06.2023; Deklarata e te pandehurit A../. P...., e dhënë në Prokurorinë Themelore Pejë Departamenti i Përgjithshëm, me datë 23.06.2023; Deklarata e dëshmitarit E... B... e dhënë në Stacionin Policor në P..., me datë 19.07.2022; Foto dokumentacioni; Raporti mbi gjendjen shëndetësore të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në P.... me nr. të referencës 15487 e datës 18.07.2022, për të dëmtuarin F....Z.....; CD-ja e siguruar nga vendi i ngjarjes; Akt-ekspertimi mjeko-ligjor datës 18.09.2022, andaj ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit i cili mbështet në provat në bazë të cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e te pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për te pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, keqë ardhjen e shfaqur nga ana e te pandehurit, është i shkurorëzuar dhe ka dy fëmijë në përkujdesje dhe atë 7 dhe 8 vite, faktin se i dëmtuari për mes parashtrësë ka deklaruar se me te pandehurin jemi shokë dhe nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj te pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si në dispozitat të këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në

parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 20 €, e duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Komfor nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, i pandehuri obligohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pagesën e taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit.

Konform nenit 359 par. 5 të KPRK gjykata ka vendosur për rrënimin e objektit si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2023:144975, 24.05.2024**

Bashkëpunëtorja profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate